


REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



# DORACAK

PËR MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT  
TË APARATIT PËR  
IDENTIFIKIM BIOMETRIK  
TË VOTUESVE (AIBV)



Viti 2021

Ky produkt është pjesë e projektit „Mbështetje për reformat zgjedhore“ të Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), realizuar nga IFES dhe KRNМ. Qëndrimet dhe përmbajtja e shprehur në këtë produkt, nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit apo realizuesve.


---

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



# DORACAK

PËR MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT  
TË APARATIT PËR  
IDENTIFIKIM BIOMETRIK  
TË VOTUESVE (AIBV)



Viti 2021



# PËRMBAJTJA

HYRJE .....	3
PERSONI I CILI MENAXHON ME APARATIN .....	4
KONTROLLIMI I FUNKSIONALITETIT TË AIBV .....	5
VOTIMI ME PËRDORIMIN E AIBV .....	7
PROCEDURA NË RAST SE AIBV NUK PUNON DHE ËSHTË I PAPËRDORSHËM .....	12
PËRFUNDIMI I VOTIMIT .....	13

# HYRJE




**N**ë zgjedhjet lokale 2021, për herë të parë futet në procedurën e votimit aparati për identifikim biometrik të votuesve (AIBV). Ai duhet ta avancojë procesin përmes digjitalizimit dhe automatizimit të një pjesë të procedurës.

Ju jeni këshillat e para zgjedhore që keni privilegjin dhe përgjegjësinë për të përdorur aparatet biometrike për identifikim të votuesve, dhe kështu të bëheni pjesë e avancimit të procedurës së votimit dhe zgjedhjeve në tërësi.


Në bazë të nenit 31 paragrafi 2 pika 2, nenit 108, nenit 108-a paragrafi 11 dhe nenit 108-b të Kodit zgjedhor, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve miratoi Udhëzim për mënyrën e konfirmimit të identitetit të votuesit.

Ky Doracak është përgatitur në bazë të atij Udhëzuesi, me qëllim për t'ju ndihmuar në përdorimin AIBV-së dhe në realizimin e votimit më 17 tetor.





## PERSONI I CILI MENAXHON ME APARATIN



1. Aparat për identifikim biometrik të votuesve (AIBV SVT 5008 me lexues MRZ)
2. Printer termal me rul letre
3. Kartelë e veçant për aktivimin e aparatit

### KUSH MENAXHON ME APARATIN?

Me aparatit për identifikim biometrik të votuesit menaxhon vetëm kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit zgjedhor të cilët kanë kartela të veçanta që janë pjesë e materialit zgjedhor konfidencial dhe ruhen në vendvotimin.

### ÇFARË NË RAST TË MUNGESËS SË KRYETARIT DHE ZËVENDËSKRYETARIT TË KZ? KU SHËNOHET KY RAST?

Në rast të mungesës së kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit zgjedhor me aparatit menaxhon personi nga Këshilli zgjedhor nga radha e administratës, i caktuar me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit zgjedhor.

### KU SHËNOHET KY RAST?

Ky rast shënohet detyrimisht në Ditarin për evidentimin e ngjarjeve, dhe atë:

- ✓ shënohen të dhënat për personin e caktuar me shumicë votash,
- ✓ shënohen të dhëna për periudhën kohore në të cilën i njëjti ka menaxhuar me AIBV-në dhe
- ✓ të dhëna për poseduesin e kartelës.

### 4 Doracak për mënyrën e shfrytëzimit të aparatit për identifikim biometrik të votuesve (AIBV)

# KONTROLLIMI I FUNKSIONALITETIT TË AIBV




## KUR BËHET KONTROLLI I FUNKSIONALITETIT TË AIBV?

Gjatë hapjes së vendvotimit, përveç kontrollit standard të ambientit dhe materialit zgjedhor konfidencial dhe jokonfidencial bëhet edhe kontrolli i funksionalitetit të AIBV-së.

## SI BËHET KONTROLLI I FUNKSIONALITETIT TË AIBV?

Kontrolli i funksionalitetit të AIBV-së bëhet në mënyrë që i njëjti aktivizohet, njoftohet personi i cili menaxhon me AIBV-në, zgjidhet gjuha për funksionimin e AIBV-së dhe shtypet raport për gjendjen momentale të të dhënave në AIBV.



## CILAT INFORMACIONE DUHET TË PARAQITEN NË EKRANIN E AIBV?


Në ekranin e AIBV-së paraqiten informacionet në vijim:

- Zgjedhjet (titulli) dhe data e zgjedhjeve
- Koha momentale
- Komuna
- Numri i vendvotimit
- Gjithsej votues të regjistruar
- Gjithsej votues që kanë votuar (vërtetim se është zero siç është evidentuar në aparatin)
- Gjithsej votues që kanë votuar dhe janë verifikuar suksesshëm me gjurmën e gishtit (vërtetim se është zero siç është evidentuar në aparatin)
- Renditja sipas gjinisë e votuesve që kanë votuar (përkatësisht zero meshkuj dhe zero femra).



## ÇFARË ME ATO INFORMACIONE?

AIBV-ja për këto informacione shtyp raport të veçantë.



## ÇFARË DUHET TË BËJË KZ ME ATË RAPORT?

Të dhënat nga raporti i shtypur shënohen detyrimisht në Procesverbalin (formulari 15) për gjendjen e konstatuar në ambientin e votimit, materialin zgjedhor dhe kutitë e votimit nga Këshilli zgjedhor për vendvotimin, ndërsa raporti i shtypur i bashkëngjitet ditarit për evidentimin e ngjarjeve.

## A JEP AIBV TË DHËNA PËR DALJEN E VOTUESVE?

AIBV-ja jep të dhëna për daljen e votuesve gjatë votimit, në interval kohor jo më gjatë se dy orë.





# VOTIMI ME PËRDORIMIN E AIBV

## KUR AKTIVIZOHET AIBV PËR IDENTIFIKIM TË VOTUESVE?

AIBV-ja aktivizohet për identifikim të votuesve me fillimin e votimit në vendvotimin.

## SI DUHET TË RRJEDHË PROCEDURA PËR IDENTIFIKIMIN E VOTUESIT?

1. Identitetin personal votuesi e dëshmon me letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme, gjegjësisht letërnjoftim ose pasaportë të cilave ju ka skaduar vlefshmëria ndërmjet datës së shpalljes të zgjedhjeve dhe ditës së votimit edhe me gjurmë të gishtit. Si pasaportë e vlefshme do të konsiderohet edhe pasaporta që vlefshmëria i ka skaduar pas 31 korrikut 2020.
2. Votuesi hyn në vendvotimin dhe ia tregon dokumentin adekuat anëtarit të Këshillit zgjedhor që menaxhon me AIBV-në, ndërsa votuesit i cili nuk ka dokument personal ose të njëjtit i ka skaduar afati i vlefshmërisë, nuk do t'i lejohet të identifikohet me gjurmë të gishtit në AIBV dhe nuk do t'i lejohet të votojë.
3. Anëtar i Këshillit zgjedhor e krahason fotografinë nga letërnjoftimi ose pasaporta me fytyrën e votuesit, e nëse konstaton se nuk është fytyra e njëjtë nuk i lejohet të identifikohet me gjurmë të gishtit në AIBV dhe nuk i lejohet të votojë.

4. Këshilli zgjedhor e vërteton identitetin dhe kontrollon nëse votuesi nuk ka votuar më parë, përmes të dhënave nga letërnjoftimi ose pasaporta dhe duke lexuar gjurmët e gishtave që duhet të përputhet me gjurmën e gishtit të votuesit në listën elektronike të zgjedhësit për vendvotimin përkatës në pajisjen teknike.
5. Këshilli zgjedhor e vërteton identitetin dhe kontrollon nëse votuesi nuk ka votuar më parë në atë mënyrë që nga votuesi merret gjurma e gishtit tregues nga dora e djathtë.





6. Nëse votuesi nuk ka gishtin e djathtë tregues, merret gjurmë nga gishti i majtë tregues.
7. Nëse votuesit i mungojnë këto dy gishta, merret gjurmë nga gishti i radhës në dorën e djathtë dhe evidentohet në ditarin për evidentimin e ngjarjeve.
8. Nëse votuesi nuk i ka të dy duart Këshilli zgjedhor e konstaton gjendjen duke evidentuar në ditarin për evidentimin e ngjarjeve dhe votuesi shënohet në pajisjen teknike duke kërkuar përmes numrit të tij amë (NUAQ).

## SI RRJEDH IDENTIFIKIMI I VOTUESIT ME AIBV?

AIBV-ja e lexon gjurmën e gishtit dhe përpiket të gjejë përputhje me gjurmët e gishtave që janë në listën elektronike të zgjedhësit për të gjitha votuesit e shënuar në atë vendotim, derisa nuk gjendet përputhje.

Nëse softueri tregon se cilësia e gjurmës është e keqe ose e dobët, softueri i AIBV-së këtë e trajton si skanim i gabuar i gjurmës së gishtit dhe kërkon përsëritje të procesit të skanimit të gishtit të njëjtë.

Nëse nuk gjendet përputhje votuesit duhet t'i skanohet gishti i majtë tregues dhe procesi përsëritet. Nëse votuesi nuk ka gishtin e majtë tregues, e jep gjurmën e gishtit sipas rendit adekuat dhe Këshilli zgjedhor këtë e evidenton në ditarin për evidentimin e ngjarjeve.





## KUR KONSIDEROHET I RREGULLT IDENTIFIKIMI?

Kur Këshilli zgjedhor konstaton se votuesi i regjistruar në listën e zgjedhësve ka dëshmuar identitetin e tij dhe ka konstatuar se votuesi nuk ka votuar më parë dhe gjurma e gishtit përputhet me gjurmën e gishtit në listën elektronike të zgjedhësve, në monitorin e aparatit do të shfaqen të dhënat nga lista e zgjedhësve të atij votues.

Nëse votuesi nuk ka votuar më parë, informacionet shfaqen me ngjyrë të gjelbër.

Një anëtar i Këshillit zgjedhor konfirmon identifikimin dhe votuesi shënohet në sistem se ka votuar.

The image displays two screenshots of a voting system interface. Both screenshots show a user profile with the following details:

- REZULTATI** (Header)
- Të dhëna personale** (Personal Data)
- Mbiemri** (Surname): STOJANOVSKA
- Emri** (Name): ANA
- Seksi** (Gender): femër
- Data e lindjes** (Date of Birth): -
- Vendi** (Place): SHKUP - KARPOSH
- Rruga** (Address): PARISKA
- Pikat e përputhjes: 0.00** (Match Score)
- ANULO** (Cancel) and **Konfirmo** (Confirm) buttons.

The left screenshot shows the interface with a green 'Vazhdo' button, indicating a successful identification. The right screenshot shows a confirmation dialog box with a question mark and the text 'Do të konfirmoni, vërtet?' (Do you confirm, really?) and 'Vërtet doni të konfirmoni këtë person?' (Really do you want to confirm this person?). The dialog box has 'ANULO' and 'VAZHDO' buttons.



## ÇFARË NËSE AIBV NUK MUND TË GJEJË PËRPTHJE TË GJURMËS SË GISHTIT?

Nëse AIBV-ja nuk mund të gjejë përputhje të gjurmës së gishtit me gjurmën e gishtave të votuesit në listën elektronike të zgjedhësve, AIBV-ja sinjalizon me ngjyrë të verdhë.

KZ-ja bën dy orvatje që të gjejë përputhje të shenjës së gishtit me anë të AIBV-së. Nëse të dy orvatjet janë pa sukses, votuesi a fshin gishtin me faculetë të thatë dhe provon edhe dy herë.

Në rast se edhe ato nuk janë të suksesshme, Këshilli zgjedhor bën konfirmimin e identitetit personal të votuesit përmes dokumentit të vlefshëm për identifikim dhe kontrollon nëse votuesi është regjistruar dhe nëse është nënshkruar në listën e shtypur të zgjedhësve.

Nëse Këshilli zgjedhor konstaton se votuesi gjendet në ekstraktin e shtypur nga lista e zgjedhësve dhe nuk ka votuar më parë, votuesi futet në AIBV-në duke lexuar dokumentin personal në skanerin MRZ ose duke shënuar numrin unik amë (NUAQ).

Nëse konfirmohet identiteti i tij përmes kësaj procedure, votuesi vë gjurmë gishti në AIBV dhe Këshilli zgjedhor e konstaton gjendjen duke e shënuar në ditarin e ngjarjeve.




Vendi për vendosjen/leximin e dokumentit për identifikim personal



## ÇFARË NËSE VOTUESI KA QENË I REGJISTRUAR NË SISTEMIN SE KA VOTUAR?

Nëse votuesi tanimë është regjistruar në sistemin se ka votuar, sistemi i paraqet informacionet me të kuqe dhe sinjalizon me alarm dhe të njëjtit nuk do t'i lejohet të votojë.



## SI RRJEDH PROCEDURA PAS KONFIRMIMIT TË IDENTITETIT TË VOTUESIT?

Pas konfirmimit të identitetit të votuesit Këshilli zgjedhor e rrethon numrin e tij rendor në ekstraktin nga lista e zgjedhësve dhe votuesi e vë nënshkrimin e tij, e nëse është analfabet vë gjurmën e gishtit të djathtë tregues.

Nëse votuesi është analfabet dhe nuk e ka gishtin e djathtë tregues, merret gjurmë nga gishti i majtë tregues, e nëse nuk e ka as të majtin nuk lihet gjurmë gishti, dhe kjo evidentohet në ditarin për evidentimin e ngjarjeve.


Pas identifikimit dhe nënshkrimit në listën e zgjedhësve votuesi merr fletëvotime.



# PROCEDURA NË RAST SE AIBV NUK PUNON DHE ËSHTË I PAPËRDORSHËM

## SI VEPRON KZ NË RAST SE AIBV ËSHTË I PARREGULLT DHE I PAPËRDORSHËM TEKNIKISHT?

Në rast se AIBV-ja është i parregullt dhe i papërdorshëm teknikisht, Këshilli zgjedhor e njofton menjëherë përmes telefonit Komisionin komunal të zgjedhjeve me qëllim Komisioni komunal i zgjedhjeve të bëjë zëvendësimin e AIBV-së.



## SI VEPRON KKZ PAS NJOFTIMIT NGA KZ?

Komisioni komunal i zgjedhjeve dërgon menjëherë person teknik i autorizuar nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve në vendotimin i cili sjell AIBV të ri – rezervë dhe aty për aty e konstaton gjendjen, me ç'rast nëse konstaton se AIBV-ja është i parregullt dhe teknikisht i papërdorshëm, e njofton me telefon Komisionin komunal të zgjedhjeve dhe e instalon aparatit e ri rezervë dhe i transferon të gjitha të dhënat në aparatit e ri.

Për transportin dhe pranimdorëzimin e aparateve Komisioni komunal i zgjedhjeve e njofton detyrimisht policinë.

## PAPËRDORSHËM DHE NUK MUND TË ZËVENDËSOHET?

Në rast se AIBV-ja është e papërdorshme dhe nuk mund të zëvendësohet Komisioni komunal i zgjedhjeve në bazë të vërtetimit nga personi profesional teknik i angazhuar nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, parashtron menjëherë në formë elektronike kërkesë me shkrim në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve i cili vendos nëse procedura e votimit do të vazhdojë në përputhje me nenin 108 të Kodit Zgjedhor.

# PËRFUNDIMI I VOTIMIT



## SI VEPRON KZ PAS PËRFUNDIMIT TË VOTIMIT?

Pas përfundimit të votimit në vendvotimin (pasi ka votuar edhe votuesi i fundit), kryetari ose zëvendëskryetari i KZ-së e çaktivizon AIBV-në për identifikim të mëtutjeshëm të votuesve, dhe nuk mund të riaktivizohet.

## CILËT TË DHËNA DUHET T'I PARAQESË AIBV?

AIBV-ja duhet automatikisht të paraqesë në ekran informacionet në vijim:

- ✓ Zgjedhjet (titulli) dhe data e zgjedhjeve
- ✓ Koha momentale
- ✓ Komuna
- ✓ Numri i vendvotimit
- ✓ Gjithsej votues të regjistruar
- ✓ Gjithsej votues që kanë votuar dhe janë verifikuar suksesshëm me gjurmën e gishtit (të shprehur në numër dhe përqindje nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për atë vendvotim)

**< PËRFUNDONI ME ZGJEDHJET** [Info] [Search] [Print] [Menu]

Të dhëna për vendvotimin	
Zgjedhje:	Zgjedhje lokale 2021
Koha dhe data aktuale:	25 shtator 2021 - 03:24
Data e zgjedhjes:	22 shtator 2021
Komuna:	EMRI I KOMUNËS
Numri i vendvotimit:	2742
Gjithsej votues të regjistruar:	147

Votues të konfirmuar: 0 (0.00%)  
sipas gjurmëve të gishtave: 0 (0.00%)  
sipas dokumentit për identifikim personal: 0 (0.00%)

- gjurmë të gishtave të konfirmuara për meshkuj: 0 (0.00%)
- dokumente për identifikim personal të konfirmuara për meshkuj: 0 (0.00%)
- gjurmë të gishtave të konfirmuara për femra: 0 (0.00%)
- dokumente për identifikim personal të konfirmuara për femra: 0 (0.00%)
- në pritje për konfirmim: 147 (100.00%)

[PRINT] [Mbyll]



- ✓ Gjithsej votues që nuk kanë mundur të identifikohen nga AIBV-ja përmes gjurmës së gishtit, e që janë identifikuar në AIBV-në përmes skanimit të dokumentit personal me skanerin MRZ ose përmes shënimit me dorë të NUAQ-it të votuesit dhe gjurma e gishtit e të cilit është marrë me AIBV (shprehur në numër dhe përqindje nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për atë vendvotim)
- ✓ Numri i meshkujve dhe femrave që kanë votuar (shprehur në numër dhe përqindje nga të gjithë votuesit që kanë votuar për atë vendvotim)

### ÇFARË DUHET TË BËJË KZ ME ATO TË DHËNA?

Aparati shtyp raport me shkrim për gjendjen, raport i cili do të jetë pjesë përbërëse e ditarit për evidentimin e ngjarjeve.

Të dhënat nga raporti i shtypur shënohen detyrimisht në Procesverbalin (formulari 16), ndërsa raporti i shtypur i bashkëngjitet ditarit për evidentimin e ngjarjeve.



